



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201602084/10

Tiranë ___/___/2017

Lënda: Rekomandohet ushtrimi kontrollit për çështjen e shtetasit G.N., në ZVRPP, Vlorë, lidhur me zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Drejtuar : **Zj. Blerina Doracaj**
Kryeregjistruesit i Zyrës Qendrore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

TIRANE

Për dijeni : **Ministrisës së Drejtësisë**

TIRANE

G.N
Adresa:

BERAT

Zj. Doracaj!

Institucioni i Avokatit në procesin e shqyrtimit të ankesës së shtetasit G..N, me banim në Lagjen "30 Vjetori", Rruga "Ilija Trebicka", Berat, në të cilën, prezantohet shqetësimi i moslëshimit të dokumenteve të pronësisë prej ZVRPP, Vlorë, për pasurinë e regjistruar në rregjistrin hipotekor me numër 1460, datë 30.09.1998, dhe nr.pas. 126/110, ZK 2832, Orikum, Vlorë, në pronësi të babait të tij, të ndjerit A.N, ka kërkuar në mënyrë të përsëritur ZQRPP, Tiranë, me shkresat Nr.K3/G25-2 Prot, datë 08.05.2017, nr.K3/G25-4 Prot, datë 29.05.2017, nr.K3/G25-6 Prot, datë 22.06.2017, dhe nr.K3/G25-7 Prot, datë 26.07.2017, informacion dhe shpjegime rreth procedimit të kryer prej saj, lidhur me ankimin datë 14.10.2016, të ankuesit G.N.

Në mënyrë të gabuar ZQRPP, Tiranë, ka përcjell për ndjekje këtë çështje pranë ZVRPP, Tiranë.

Çështja për të cilën është kërkuar në mënyrë të përsëritur informacion dhe shpjegime ZQRPP, Tiranë, ka të bëjë me informimin rreth procedimit të mundur të kryer, lidhur me, ankesën datë 14.10.2016, që ankuesi ka depozituar pranë organit që ju përfaqësoni.

Referuar akteve të venë në dispozicion prej ankuesit, rezulton se; i ndjeri A.N, babai i ankuesit, ka blerë sipas Kontratës së Shitblerjes nr. 8917 Rep, nr.8454 Kol, datë 30.09.1998, redaktuar para Noteres Jetmira Veraj, Vlorë, 420 m2 tokë truall. Regjistrimi i kësaj kontrate pranë Ish-Hipotekës, Vlorë, sot ZVRPP, Vlorë, është kryer në regjistrin hipotekor me nr.1460, datë 30.09.1998, duke u lëshuar me këtë rast pronarit, prej ZVRPP, Vlorë, Vërtetim “Nga dokumentet hipotekor”, datë s’ka, konform kërkesës së tij nr.25, datë 07.01.2004, apo Vërtetim “Nga dokumentet hipotekor”, datë 23.06.2010, për pasurinë truall me sipërfaqe 420 m2, regjistruar me nr.1460, datë 30.09.1998, të regjistrit hipotekor.

Me rastin e hedhjes në sistem të Zonës Kadastrale nr.2832, ku dhe ndodhet pasuria e regjistruar me numër hipotekor 1460, datë 30.09.1998, ankuesi G.N., ka kërkuar (aplikimi 9163, datë 09.08.2016) pajisjen e tij me dokumentacion pronësie mbi pasurinë truall me sipërfaqe 420 m2, regjistruar me nr.1460, datë 30.09.1998, në regjistrin hipotekor të ZVRPP, Vlorë. Sqarojmë se, kërkesa nga ana e ankuesit është kryer me rastin e depozitimit nga ana e tij të dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerin A.N., si dhe Prokurës së Përgjithshme nr. 752 Rep, nr.196 Kol, datë 11.04.2016, redaktuar para Noterit Ermir Islamaj, Vlorë.

Në përgjigje të kërkesës (aplikimi 9163, datë 09.08.2016) ZVRPP, Vlorë, me shkresën nr. 3752, datë 23.08.2016, kthen përgjigje kërkuarit GN, midis të tjerave, se;

“... Pasuria me nr.126/2 është në emër të bashkëpronësisë Gj. Për sa sipër ju nuk mund të pajiseni me certifikatë pronësie për këtë pasuri”.

Kundër këtij qëndrimi të shprehur prej ZVRPP, Vlorë, ankuesi i është drejtuar ZQRPP, Tiranë, me ankesën datë 14.10.2016, për të cilën shprehet se, ende nuk ka marrë përgjigje, duke kërkuar me këtë rast, dhe ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit për rivendosjen në vend të së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor si dhe të drejtës së pronësisë.

Qëndrimin e mbajtur prej ZVRPP, Vlorë, në situatën e perezantuar të çështjes nuk e vlerësojmë të rregullt, sikurse dhe qëndrimin e ZQRPP, Tiranë, për mosprocedim lidhur me ankesën datë 14.10.2016, të ankuesit G.N.

Në kushtet kur ZVRPP, Vlorë, nuk ka përmbushur detyrimin sikurse kërkuar prej ankuesit, gjykojmë se, ky qëndrim nuk vjen në përputhje me parimet e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, si ai i ligjshmërisë, mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave të personave privat, drejtësisë dhe paanësisë, të detyrueshme për zbatim në kuptim dhe zbatim të nenit 1 të këtij Kodi.

Për arsyet e bëra me dije në këtë shkresë, Institucioni i Avokatit të Popullit bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”*, si dhe nenit 21/b, se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”.*

REKOMANDOJMË

Ushtrimi kontrollit për çështjen e shtetasit G.N., në ZVRPP, Vlorë, lidhur me zbatimin e legjislacionit në fuqi, si dhe përfundimin e procesit administrativ sa më parë prej ZQRPP, Tiranë, lidhur me ankesën datë 14.10.2016, të ankuesit.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Kopje të Kërkesës nr.K3/G25-2 Prot, datë 08.05.2017, nr.K3/G25-4 Prot, datë 29.05.2017, nNr.K3/G25-6 Prot, datë 22.06.2017, dhe nr.K3/G25-7 Prot, datë 26.07.2017, të Avokatit të Popullit drejtuar ZQRPP, Tiranë.

Kopje të shkresës nr.3658/1 Prot, datë 15.06.2017, të Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira drejtuar ZQRPP, Tiranë.

Kopje të shkresës nr.4807/1 Prot, datë 21.08.2017, të Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira drejtuar ZQRPP, Tiranë.

Kopje të ankesës datë 14.10.2016, të ankuesit G.N drejtuar ZQRPP, Tiranë.

Kopje të Kontratës së Pjestimit Nr. 8888 Rep, Nr.8439 Kol, datë 18.09.1998, redaktuar para Noteres Jetmira Veraj.

Kopje të Kontratës së Shitblerjes nr. 8917 Rep, nr.8454 Kol, datë 30.09.1998, redaktuar para Noteres Jetmira Veraj, Vlorë.

Kopje të Vërtetimit “Nga dokumentet hipotekor”, datë s’ka, lëshuar prej ZVRPP, Vlorë, konform kërkesës së pronairit nr.25, datë 07.01.2004, për pasurinë truall me sipërfaqe 420 m2, regjistruar me nr.1460, datë 30.09.1998, të regjistrit hipotekor.

Kopje të Vërtetimit “Nga dokumentet hipotekor”, datë 23.06.2010, për pasurinë truall me sipërfaqe 420 m2, regjistruar me nr.1460, datë 30.09.1998, të regjistrit hipotekor.

Kopje të Letrës padatë të ankuesit G.N drejtuar ZVRPP, Vlorë.

Kopje të Prokurës së Përgjithshme nr.752 Rep, nr.196 Kol, datë 11.04.2016, redaktuar para Noterit Ermir Islamaj.

Kopje të kërkesës (aplikimit 9163, datë 09.08.2016) të kryer prej G.N pranë ZVRPP, Vlorë.

Kopje të shkresës nr. të ZVRPP, Vlorë, drejtuar G.N.

Kopje të plan rilevimit të përgatitur prej topografit Adiselo Rrapaj për pasurinë nr.126/110, ZK 2832, Orikum, Vlorë.

KOMISIONERI

Arben SHKEMBI